



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 73, Datë 10.05.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE TË EVROPËS KONTINENTALE PËR KARAKTERISTIKAT SHITESË TË FRC NË PËRPTHJE ME NENIN 154 (2) TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË BE 2017/1485 TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje nenit 7, nenit 19 si dhe neni 67, ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, nenit 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”; në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 167 të Kodit të Transmetimit të miratuar me Vendim të ERE nr.186 dt. 10/11/2017; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe duke konsideruar se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a, është anëtar me të drejta të plota i ENTSO-E, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për fillimin e procedurës për miratimin e Propozimit të të gjithë OST-ve të Evropës kontinentale për karakteristikat shtesë të FRC në përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- OST sh.a. me shkresën nr. 2060 Prot., datë 15.03.2019, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjithë OST-ve të Evropës kontinentale për karakteristikat shtesë të FRC në përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Nenit 7 dhe Neni 19, si dhe neni 67 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendim të bordit të ERE nr.186 dt. 10/11/2017, përkatësisht neni 167 “ Sigurimi i FCR-së”.
- “Rezervat e mbajtjes së frekuencës” ose “FCR” nënkupton rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një çekuilibrimi.
- Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 i rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 të datës 2 gusht 2017,

Ky dokument vjen si propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Trasmimit të zonës sinkron të Europës Kontinentale në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 (2) i Rregullores së Komisionit BE 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Propozimit të të gjithë OST-ve të Evropës kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR në përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI